



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

K.P.P. 596/2020

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.12.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Inpress” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me numër REF-74817-10-12-2020, me objekt, “Shërbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e UKD”, me fond limit 6.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 23.10.2020, nga autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime sh.a Durrës.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Adel Co” sh.p.k në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues: “Inpress” sh.p.k.
Rruga “Siri Kodra” ish-blloku i magazinave –Tiranë.

“Inform Albania” shpk.
Rruga “Çerçiz Topulli”, Nr.17 Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Ujësjiellës Kanalizime sh.a, Durres
Lagjia 17, Rruga ”Dalip Peza”, Durrës.

Subjekte të interesuar: “Adel co” shpk
Rruga “Muhamet Gjollësja”, tek Zogu i Zi, Tiranë.

“Infotech Dr” shpk
Rruga “H. Troplini”, Zona Kadastrale 8514, Pasuria 3/134,
Kati perdhe, Durres.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.10.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me Nr. REF-74817-10-12-2020, me objekt, “Shërbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat UKD”, me fond limit 6.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 23.10.2020, nga autoriteti kontraktor Ujesjellës Kanalizime sh.a Durres.

II.2. Në datën 23.10.2020 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 29.10.2020, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- “Inpress” shpk	4696221.20	I skualifikuar
- “Adel Co” shpk	4899012.57	I kualifikuar
- “Inform Albania” shpk	5123150.40	I kualifikuar
- “Infotech Dr” shpk	5362800.00	I skualifikuar

II.3.1. Operatori ekonomik “Inpress” sh.p.k është njoftuar për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se nuk permbush:

1.Kapacitetin teknik pika 8 / pasi; nuk është paraqitur autorizim prodhuesi të softit nga Objektif Lune, për të vërtetuar lidhjen që ka ky prodhues me kontraktuesin Kallfa shpk.

2.Kapacitetin Teknik pikat 9/ pasi; nuk u paraqiten mostrat në orën e kërkuar, ku ishin të pranishëm dhe tre operatorët e tjerë pjesëmarrës, por 30 minuta me vonë. KVO gjatë procedurës së vlerësimit nuk i merr në shqyrtim mostrat e paraqitura nga ana juaj.

II.4. Në datën 03.11.2020, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, pala ankimuese kundërshton vendimin e KVO-së me argumentat se:

- *Në vijim të procedurës së prokurimit publik të Autoritetit Kontraktor Ujesjellës Kanalizime Sh.A Durres, me objekt: "Shërbim printimi dhe zarfimi të faturave për nevojat e UKD", dhe me Fond limit: 6.500.000 (gjashtë milion e pesëqind mijë) leke*

pa TVSH, publikuar me date 13.10.2020, e cila u zhvillua me datë 23.10.2020 (afati perfundimtar per dorezimin e ofertave).

- Vleresimi i Ofertave te Tenderit per proceduren e prokurimit te lartpermendur u zhvillua nga Autoriteti Kontraktor ne daten 29.10.2020. Ne kete procedure prokurimi paraqiten ofertat ekonomike operatoret ekonomike te poshteshenuar, te cilet autoriteti kontraktor i klasifikoi ne kete menyre:
 - "Inpress" shpk 4696221.20 I skualifikuar
 - "Adel Co" shpk 4899012.57 I kualifikuar
 - "Inform Albania" shpk 5123150.40 I kualifikuar
 - "Infotech Dr" shpk 5362800.00 I skualifikuar

II.6. Në njoftimin e marrë nëpërmjet sistemit elektronik te APP, Komisioni i Vleresimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor Ujësjetllës Kanalizime Sh.A Durrës, ka informuar OE "Inpress" shk se:

"Operatori Ekonomik "Inpress" shpk., është "skualifikuar" për arsyet e mëposhtme:

- a) Nuk përmbush: 1. Kapaciteti. teknik pika 8 / pasi është paraqitur autorizim prodhuesi te softit Objektiv Lune, per të vërtetuar lidhjen me kontraktuesin Kallfa shpk";
- b) Kapacitetin Teknik pikat 9 / pasi nuk u paraqiten mostrat në orën e kerkuar, ku ishin të pranishëm dhe tre OE pjesëmarrës, por 30 minuta. më vonë. KVO gjatë procedures së vlerësimit nuk i merr në shqyrtim mostrat e paraqitura nga ana juaj."

Duke qene se ky vendim i KVO, te Autoritetit Kontraktor eshte teresisht i gabuar dhe bie në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nenligjore te fushes, ne fuqi, mbeshtetur ne nenin 63 pika 2, te ligjit nr 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", indryshuar, si dhe Vendimit te Këshillit te Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 "Per rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, në vijim të procesit të rivleresimit të ofertave për tenderin, dhe brenda afatit 7 ditor nga dita e nesërme e njoftimit nga ana e Autoritetit Kontraktor të ketij vendimi, Ju kërkojmë ndryshimin e këtij vendimit të KVO-së të AK, duke parashtruar kundërshtitë tona, si dhe arsyet ligjore ku bazohen këto kundërshti, si vijon:

* * *

➤ *Persa i perket vendimit te KVO te AK, per Skualifikimin e Operatorit Ekonomik "Inpress" shpk., Ju paraqesim kundërshtitë tona si vijon:*

1. *Persa i perket arsyes se pare skualifikimit te OE "Inpress" shpk te perdorur nga AK si me poshte:*

a) *"Nuk përmbush: Kapacitetin teknik pika 8 / pasi nuk eshte paraqitur autorizim prodhuesi te softit Obiektiv Lune, per te vertetuar lidhjen me kontraktuesin "Kallfa" shpk. do te donim te parashtronim sa meposhte vijon:*

Ne piken 2.3.8 "Kapacitetet Teknike", te shtojces 7, ne Dokumentat Standarte te Tenderit per proceduren e prokurimit te lartpermendur, Autoriteti Kontraktor Ujesjelles Kanalizime ShA Durres është përcaktuar se:

"Operatori ekonomik duhet te disponoje nje soft menaxhimi dhe monitorimi te punes (printimit dhe zarfimit te faturave) ne kohe reale. Per te provuar disponimin e ketij softi duhet te paraqesë LICENSEN e software-it ose autorizim prodhuesi të softit ose distributorit."

OE "Inpress" shpk., ne perputhje te plote me kerkesat e kesaj pike te DST, ka paraqitur dokumentacionin ligjor si me poshte vijon:

i. Kontrate per venien ne dispozicion, dhenien e sherbimeve te operimit dhe mirembajtjes (Per sistem software (sistem operativ dhe aplikacion) per perpunimin e te dhenave dhe krijimin e fileve per print) ndermjet shoqerise Kallfa shpk. (pronari i Softit dhe Licencës) dhe OE "Inpress" shpk., date 06.09.2020 me ane te se ciles, OE "Inpress" shpk., i vihet ne dispozicion:

- Sistemi Software "Planet Press Production";*
- Licenca nr.AA5-50-07062-V4YC-5BQ.*

ii. Fature Tatimore nr. 1813509, date 19.06.2012, me shites shoqerine "Objectif Lune" dhe bleres shoqerine "Kallfa" shpk. (ku perfshihet edhe Licenca nr. AA5-50-07062-V4YC-5BQ).

I gjithe dokumentacioni ligjor i lartpermendur eshte depozituar rregullisht nga OE "Inpress" shpk. ne sistemin elektronik te APP, ditën e hapjes se tenderit, dhe si rrjedhoje lehtesisht i verifikueshem, pasi kemi te bejme me nje situatë faktike.

Bazuar ne kerkesat e DST se kesaj procedure prokuruese dhe dokumentacionit ligjor te paraqitur nga OE "Inpress" shpk., e kemi te veshtire te kuptojme si KVO e AK ka arritur ne konkluzionin, se OE "Inpress" shpk. nuk permbush kete kriter teknik???

Ne piken 2.3.8 "Kapacitetet Teknike", te shtojces 7, ne Dokumentat Standarte te Tenderit per proceduren e prokurimit te lartpermendur, percaktohet qartesisht se OE pjesemarrës duhet te vertetojne se disponojne:

- Ose Licencën e Software- it;*
- Ose autorizim prodhuesi te softit ose distributorit;*

Në rastin konkret, OE "Inpress" shpk. ka paraqitur Ivertetuar disponimin e Licences se Software- it (Sistemi Software "Planet Press Production"), me Licence nr. AAS-50-07062-V4YC-5BQ, e cila eshte ne pronesi te shoqerise "Kallfa" shpk., dhe OE "Inpress" shpk, e disponon me anë te Kontrates "Kontrate per venien ne dispozicion, dhenien e sherbimeve te operimit dhe mirembajtjes (Per sistem softeware (sistem operativ dhe aplikacion) per perpunimin e te dhenave dhe krijimin e fileve per print)".Si rrjedhoje,

bazuar ne dokumentacion ligjor te paraqitur nga OE "Inpress"shpk",vertetohet qartësisht se ky OE disponon ligjërisht Licencen e Software- it.

Bazuar ne piken 2.3.8 "Kapacitetet Teknike", te shtojces 7, ne Dokumentat Standarte te Tenderit per proceduren e prokurimit te lartpermendur, disponimi i Licences se Software eshte nje alternative e Autorizimit të Prodhuesit ose distributorit. Si rrjedhoje, arsyeja e parashtruar nga KVO e AK per skualifikimin e OE "Inpress"shpk. " pasi nuk është paraqitur autorizim prodhuesi. "

QARTESISHT NUK QENDRON!

Per sa me siper, mund te arrijme lehtesisht ne konkluzionin se KVO e AK ka gabuar teresisht ne vleresimin e dokumentacionit ligjor te paraqitur nga OE "Inpress"shpk.,pasi ne kundërshtim me kerkesat e pikes 2.3.8 te shtojces 7, te DST, ne menyre te kundraligjshme, ka konsideruar kriterin e "autorizimit te prodhuesit ose distributorit",si plotesuese te kriterit te Disponimit te Licences, dhe JO SI NJE ALTERNATIVE E SAJ.

Si rrjedhoje, KSHA e AK do te duhet ta ndryshoje vendimin e marre nga KVO dhe te konsideroe te plote dhe te rregullt dokumentacionin ligjor te paraqitur nga OE "Inpress"shpk., persa i perket kesaj pike.

Persa i perket arsyes se dyte te skualifikimit te OE "Inpress" shpk., te perdorur nga AK si me poshte:

b) "Kapacitetin Teknik pikat 9/ pasi nuk u paraqiten mostrat në orarin e kerkuar,ku ishin të pranishëm dhe tre oe pjesëmarrës,por 30 minuta më vonë. .KVO gjatë procedures së vlerësimit nuk i merr në shqyrtim mostrate paraqitura nga ana juaj."

Ne piken 2.3.9 "Kapacitetet Teknike", te shtojces 7, ne Dokunentat Standarte te Tenderit per proceduren e prokurimit te lartpermendur, eshte percaktuar se:

"Te paraqese 10 cope fatura sipas të gjitha specifikimeve teknike te kerkuara ne dst ne daten dhe oren e hapjes së procedures. "

OE "Inpress" shpk., ne perputhje te plote me kerkesat e kesaj pike te DST, ekzaktesisht ne daten dhe oren e hapjes se ofertave (date 23.10.2020; ora 10:00) eshte paraqitur me Autorizim z. Denis Dervishi (punonjes i OE "Inpress" shpk.), i cili ka depozituar rregullisht prane AK:

i. Autorizimin e përfaqësimit të OE "Inpress"shpk.;

ii. Mostrat (10 cope fatura) sipas te gjitha specifikimeve teknike te kerkuara ne DST;

iii. Analizat Laboratorike për peshën/gramaturën 90 gr, për letrën e kërkuar në DST.

Pas dorezimit te mostrave te kerkuara, si dhe dokumentacionit ligjor/teknik te kerkuar, te cilat u pranuan rregullisht nga AK Ujesjelles Kanalizime Sh.A Durres, eshte perpiluar edhe Procesverbali "Per paraqitjen e mostrave", nenshkruar rregullisht nga perfaqesuesi i OE "Inpress"shpk., dhe perfaqesuesit e AK.

Persa i perket ARSYEVE ABSURDE te perdorura nga KVO e AK, per skualifikimin e OE "Inpress" shpk", ne lidhje me kete kriter, do te donim te parashtronim sa me poshte vijon:

Perfaqesuesi me Autorizim i OE "Inpress" shpk., z. Denis Dervishi (punonjës i OE "Inpress" shpk. eshte paraqitur fizikisht prane ambienteve te AK Ujesjelles Kanalizime Sh.A Durres, ne oren 9:45, te dates 23.10.2020.

Se bashku me Operatoret e tjere Ekonomike pjesëmarrës ne kete procedure prokuruese, perfaqesuesi me Autorizim i OE "Inpress" shpk., ka pritur oren 10:00, te date 23.10.2020, per dorezimin e mostrave te kerkuara, si dhe dokumentacionit ligjor/teknik te kerkuar;

Ne oren 10:00 te dates 23.10.2020, nga ana e perfaqesuesve te AK Ujësjetllës Kanalizime Sh.A Durres, duke marre parasysh edhe situaten e renduar COVID-19, ju eshte kerkuar perfaqesuesve me autorizim te OE pjesemarrës: Të hyjë dhe te dorëzojne me rradhë (dhe jo te gjithë sebashku ne te njejten kohe) mostrat e kerkuara ne DST;

Si rrjedhoje e ketij vendimi/kerkese te perfaqesuesve te AK, rradha per dorezimin e mostrave nga ana e perfaqesuesit te OE "Inpress" shpk., ka ardhur ne oren 10:30, te dates 23.10.2020, duke dorezuar keshtu rregullisht mostrat e kerkuara;

Pas dorezimit te mostrave, eshte perpiluar i mbajtur dhe firmosur rregullisht edhe procesverbali "Per paraqitjen e mostrave" ;

Asnje pretendim apo kundërshti nuk eshte ngritur nga ana e perfaqesuesve te AK ujesjelles kanalizime sh.a Durres ne lidhje me orarin e dorezimit te mostrave, nga ana e OE "Inpress" shpk. ne momentin e dorezimit te mostrave dhe mbajtjes se procesverbalit;

Persa me siper, do te donim te parashtronim gjithashtu:

i. Ne zbatim te LPP-se, NUK eshte detyre e KVO te AK, te "vleresoje" ne nje moment te dyte, nese nje OE pjesemarrës eshte paraqitur ne oren dhe daten e caktuar per dorezimin e mostrave apo jo;

ii. Ne zbatim te LPP-se, nese nje OE pjesemarrës, paraqitet me vonese, ne raport me orarin e percaktuar ne DST, AK ka detyrimin ligjor te mos i pranojë mostrat nga OE pjesemarrës, duke refuzuar keshtu dorezimin fizik te tyre;

iii. Si rrjedhoje, AK nuk ka te drejte të perpiloje/mbaje asnje procesverbal "Per paraqitjen e mostrave", por thjeshtë do te duhet te refuzoje pranimin e mostrave.

iv. Ne zbatim te LPP-se, ne momentin qe mostrat dorezohen rregullisht, dhe per kete qellim perpilohet/mbahet dhe nenshkruhet rregullisht, nga perfaqesuesit e te dy paleve Procesverbali "Per paraqitjen e mostrave", ky proces konsiderohet i ezauruar/mbyllur plotesisht dhe rregullisht, dhe asnje person apo Komision nuk mund te kundërshtojë apo, aq me shume, "vleresoje" kete suate faktike ne nje moment te dyte.

Nga sa më sipër, KSHA do të duhet ta ndryshojë vendimin e marre nga KVO dhe të konsiderojë të plote dhe të rregullt mostrat dhe dokumentacionin ligjor/teknik të paraqitur nga OE "Inpress" shpk., persa i perket kesa pike.

Per të gjitha sa u parashtruan, kerkojme nga KSHA e AK:

i) Ndryshimin e vendimit të KVO të AK;

ii) Kualifikimin e OE "Inpress" shpk.;

iii) Shpalljen fitues të procedurës së prokurimit publik, objekt i kesaj ankese OE "Inpress" shpk.

II.7. Në datën 11.11.2020, nëpërmjet shkresës me nr. 2432/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke pranuar pjesërisht ankesën dhe duke argumentuar: " Lidhur me arsyen e skualifikimit të OE "Inpress" shpk për arsye se nuk ka përmbushur pikën 9 të të Kapacitetit teknik 2.3 " Të paraqesë 10 copë fatura sipas të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara në DST në datën dhe orën e hapjes së procedurës:

KSHA vëren se:

Me datë 23.10.2020, KVO ka mbajtur procesverbal për paraqitjen e mostrave dhe e ka pasqyruar me shkresën nr.2619/15 prot, datë 23.10.2020. Nga verifikimi i procesverbalit vërehet se KVO është shprehur: "U hapën mostrat e OE Inpress shpk përfaqësuar me autorizimin e dt 23.10.2020 nga z. Denis Dervishi i cili ka paraqitur pranë UKD sha mostrat për 10 modele fatura të kërkuara nga Enti Prokurues (Sipas mostrave bashkëlidhur). Mostrat nga ana verbale i plotësojnë specifikimet teknike. Referuar P.V të paraqitjes së mostrave KVO nuk është shprehur në asnjë moment që OE "Inpress" shpk ka paraqitur mostrat jashtë afatit kohorë të përcaktuar në DST. Ndërsa në PV e vlerësimit KVO në lidhje me këtë pikë ka bërë skualifikimin e OE dhe është shprehur: ' OE nuk ka paraqitur mostrat në orën e kërkuar . por 30 min me vonësë. dhe KVO nuk i ka marrë në shqyrtim mostrat e paraqitura."

Nga sa më sipër KSHA gjykon se:

KVO në lidhje me këtë pikë nuk duhet të bënte skualifikimin e OE pasi ka kundërthënë midis P.V të paraqitjes së mostrave dhe P.V të vlerësimit ku në të dyja rastet provesverbalet janë mbajtur nga i njëjti Komision.

Në lidhje me këtë pikë ankesa e bërë nga OE të merret në konsideratë.

- Lidhur me arsyen e skualifikimit të OE Inpress shpk për arsye se nuk ka përmbushur: pika 8 të Kapacitetit teknik 2.3 " Operatori ekonomik duhet të disponojë një soft menaxhimi dhe monitorimi të punës (printim dhe zarfimit të faturave) në kohë reale. Për të provuar disponimin e këtij softit duhet të paraqesë licensën e software-it ose autorizimin e prodhuesit të softit ose distributorit.*

KSHA vëren se:

OE ankimues ditën e hapjes së ofertave në lidhje me këtë pikë ka ngarkuar në SPE kontratë shërbimi midis shoqërisë Inpress shpk si marrës i shërbimit dhe shoqërisë Kallfa shpk si ofrues i shërbimit me objekt vënien në dispozicion të marrësit të shërbimeve:

- Sistem software për përpunimin e të dhënave dhe krijimin e fileve për print Planet Press Production.*

- *Pronësinë e sistemit software të vënë në dispozicion nga shoqëria Kallfa shpk, provohet nëpërmjet.*
- *Faturë tatimore nr. 1813509 datë 19.06.2012 me shitës Objektif Luna dhe blerës shoqëria Kallfa shpk.*

Nga sa më sipër KSHA vëren se:

Së pari, në lidhje me plotësimin e këtij kriteri OE nuk ka paraqitur një autorizim prodhuesi të softit nga Objektif Luna, autorizim i cili do të bënte lidhjen midis prodhuesit të softit me subjektin Kallfa shpk. Gjithashtu nga OE nuk është paraqitur fizikisht licensë e softit por thjeshtë OE ka paraqitur në kontratë Licensën nr. AAS-50-07062-V4YC-5BQ.

Së dyti nga verifikimi i faturës tatimore me nr.1813509, datë 19.06.2012 si i vetmi dokument që tregon origjinën e produktit (softit të kërkuar) ndër zërat e vendosura në faturë është dhe shërbimi i mirëmbajtjes së këtij produkti nga shitësi Objektif Luna. Ky shërbim i ofrohet blerësi Kallfa shpk për një periudhë kohore 1 vjecare. Duke qenë se blerja është kryer në vitin 2012, afati i përfundimit të mirëmbajtjes së produktit software nga shitësi Objektif Luna ka përfunduar në vitin 2013, kjo sipas të dhënave në faturë. Nga sa më sipër OE duhet të kishte paraqitur dokumentat plotësuese ku të provonin që disponojnë soft menaxhimi.

Ankesa e bërë në lidhje me këtë pikë nga OE nuk merret në konsideratë.

Për sa më sipër Grupi i shqyrtimit të ankesa në mbështetje të pikës 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, prot, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 78, pika 6/a, vendosi të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik "Inpress" shpk.

II.8. Në datën 13.11.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke pretenduar se:

I. Vleresimi i Ofertave të Tenderit për procedurën e prokurimit të lartpërmendur u zhvillua nga Autoriteti Kontraktor në datën 29.10.2020. Në këtë procedurë prokurimi paraqiten ofertat ekonomike operatorët ekonomikë të poshteshënuar, të cilët autoriteti kontraktor i klasifikoi në këtë mënyrë:

- "Inpress" shpk	4696221.20	I skualifikuar
- "Adel Co" shpk	4899012.57	I kualifikuar
- "Inform Albania" shpk	5123150.40	I kualifikuar
- "Infotech Dr" shpk	5362800.00	I skualifikuar

II.9. Në njoftimin e marrë nëpërmjet sistemit elektronik të APP, Komisioni i Vleresimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor Ujësjellës Kanalizime Sh.A Durrës, ka informuar OE "Inpress" shpk se:

"Operatori Ekonomik "Inpress" sh.p.k., është "skualifikuar" për arsyet e mëposhtme:

- a) *Nuk përmbush: 1. Kapaciteti teknik pika 8/pasi nuk është paraqitur autorizim prodhuesi të softit Objektif Lune, për të vërtetuar lidhjen me kontraktuesin Kallfa shpk";*

- b) Kapacitetin Teknik pikat 9/pasi nuk u paraqiten mostrat në orën e kerkuar, ku ishin të pranishëm dhe tre OE pjesëmarrës, por 30 minuta më vonë. KVO gjatë procedurës së vlerësimit nuk i merr në shqyrtim mostrat e paraqitura nga ana juaj."

Në datën 03.11.2020. OE Inpress shpk, paraqiti ankesë pranë AK "Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Durrës" duke kundërshtuar vendimin e KVO të AK në lidhje me arsyet e skualifikimit të OE Inpres shpk.

Ujësjetllës kanalizime sh.a Durrës me anë të shkresës nr.2432/1, datë 11.11.2020 "Kthim përgjigje" ka pranuar pjesërisht ankesën e OE Inpress shpk përsa i përket arsyes së parë të skualifikimit.

Duke qenë se ky vendim i AK është i gabuar dhe bie në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nenligjore në fuqi përsa i përket aspektit material.....

Duke qene se ky vendim i KVO, te Autoritetit Kontraktor eshte teresisht i gabuar, dhe bie ne kundershjim me dispozitat ligjore dhe nenligjore te fushes, ne fuqi,përsa i përket aspektit material

.....mbeshtetur ne nenin 63 pika 6, te ligjit nr 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" indryshuar, si dhe Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Per rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, në vijim të procesit të rivlerësimit të ofertave për tenderin, dhe brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 63, pika 6 të LPP-së, Ju kërkohet ndryshimin e këtij vendimit të AK, duke parashtruar kundërshtitë tona, si dhe arsyet ligjore ku bazohen këto kundërshti, si vijon:

- Përsa i përket vendimit të AK, për Skualifikimin e Operatorit Ekonomik "Inpress" shpk., Ju paraqesim kundërshtitë tona si vijon:

1. KVO e AK përsa i përket arsyes së skualifikimit të OE "Inpress" ka parashtruar si me poshte:

"Nuk permbush: Kapacitetin teknik pika 8 / pasi nuk eshte paraqitur autorizim prodhuesi te softit Objektif Lune, per te vertetuar lidhjen me kontraktuesin "Kallfa" shpk.

Në ankesën e ushtruar nga OE Inpress shpk pranë Ak "Ujësjetllës Kanalizime sh.a Durrës" të datës 03.11.2020, është kundërshtuar vendimi i KVO të AK në lidhje me këtë arsye të skualifikimit të OE Inpress shpk duke u parashtruar sa më poshtë vijon:

Ne piken 2.3.8 "Kapacitetet Teknike", te shtojces 7, ne Dokumentat Standarte te Tenderit per proceduren e prokurimit te lartpermendur, Autoriteti Kontraktor Ujesjelles Kanalizime ShA Durres është përcaktuar se:

"Operatori ekonomik duhet te disponoje nje soft menaxhimi dhe monitorimi te punes (printimit dhe zarfimit te faturave) ne kohe reale. Per të provuar disponimin e ketij softit duhet te paraqesë LICENSEN e software-it ose autorizim prodhuesi të softit ose distributorit. "

OE "Inpress" shpk., ne perputhje te plote me kerkesat e kesaj pike te DST, ka paraqitur dokumentacionin ligjor si me poshte vijon:

i. Kontrate per venien ne dispozicion, dhenien e sherbimeve te operimit dhe mirembajtjes (Per sistem software (sistem operativ dhe aplikacion) per perpunimin e te dhenave dhe krijimin e fileve per print) ndermjet shoqerise Kallfa shpk. (pronari i Softit dhe Licencës) dhe OE "Inpress" shpk., date 06.09.2020 me ane te se ciles, OE "Inpress" shpk., i vihet ne dispozicion:

- Sistemi Software "Planet Press Production";

- Liçenca nr. AA5-50-07062-V4YC-5BQ.

ii. Fature Tatimore nr. 1813509, date 19.06.2012, me shites shoqerine "Objectif Lune" dhe bleres shoqerine "Kallfa" shpk. (ku perfshihet edhe Licenca nr. AA5-50-07062-V4YC-5BQ).

I gjithe dokumentacioni ligjor i lartpermendur eshte depozituar rregullisht nga OE "Inpress" shpk. ne sistemin elektronik te APP, ditën e hapjes se tenderit, dhe si rrjedhoje lehtesisht i verifikueshem, pasi kemi te bejme me nje situate faktike.

Bazuar ne kerkesat e DST se kesaj procedure prokuruese dhe dokumentacionit ligjor te paraqitur nga OE "Inpress" shpk., e kemi te veshtire te kuptojme si KVO e AK ka arritur ne konkluzionin, se OE "Inpress" shpk. nuk permbush kete kriter teknik???

Ne piken 2.3.8 "Kapacitetet Teknike", te shtojces 7, ne Dokumentat Standarte te Tenderit per proceduren e prokurimit te lartpermendur, percaktohet qartesisht se OE pjesemarres duhet te vertetojne se disponojne:

- Ose Licencen e Software- it;

- Ose autorizim prodhuesi te softit ose distributorit;

Në rastin konkret, OE "Inpress" shpk. ka paraqitur/vertetuar disponimin e Licences se Software- it (Sistemi Software "Planet Press Production"), me Licence nr. AAS-50-07062-V4YC-5BQ, e cila eshte ne pronesi te shoqerise "Kallfa" shpk., dhe OE "Inpress" shpk, e disponon me anë te Kontrates "Kontrate per venien ne dispozicion, dhenien e sherbimeve te operimit dhe mirembajtjes (Per sistem softeare (sistem operativ dhe aplikacion) per perpunimin e te dhenave dhe krijimin e fileve per print)". Si rrjedhoje, bazuar ne dokumentacion ligjor te paraqitur nga OE "Inpress" shpk., vertetohet qartësisht se ky OE disponon ligjërisht Licencen e Software- it.

Bazuar ne piken 2.3.8 "Kapacitetet Teknike", te shtojces 7, ne Dokumentat Standarte te Tenderit per proceduren e prokurimit te lartpermendur, disponimi i Licences se Software eshte nje alternative e Autorizimit të Prodhuësit ose distributorit. Si rrjedhoje, arsyeja e parashtruar nga KVO e AK per skualifikimin e OE "Inpress" shpk. ".pasi nuk është paraqitur autorizim prodhuesi..... "

QARTËSISHT NUK QËNDRON!

Per sa më sipër, mund të arrijmë lehtësisht në konkluzionin se AK ka gabuar teresisht në vlerësimin e dokumentacionit ligjor të paraqitur nga OE "Inpress" shpk., pasi në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.8 të shtojcës 7, të DST, në mënyrë të kundërligjshme, ka konsideruar kriterin e "autorizimit të prodhuesit ose distributorit", si plotësuese të kriterit të Disponimit të Licencës, dhe JO SI NJE ALTERNATIVE E SAJ.

Si rrjedhojë, KSHA e AK do të duhet ta ndryshojë vendimin e marrë nga KVO dhe të konsiderojë të plote dhe të rregullt dokumentacionin ligjor të paraqitur nga OE "Inpress" shpk., për sa i përket kesaj pike.

III. Ujësjetës Kanalizime sh.a Durrës, me anë të shkresës nr.2432/1, datë 11.11.2020 "Kthim përgjigje" duke refuzuar ankesën e OE Inpress shpk, në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar sa më poshtë vijon:

Nga sa më sipër KSHA vëren se:

Së pari, në lidhje me plotësimin e këtij kriteri OE nuk ka paraqitur një autorizim prodhuesi të softit nga Objectif Luna, autorizim i cili do të bënte lidhjen midis prodhuesit të softit me subjektin Kallfa shpk. Gjithashtu nga OE nuk është paraqitur fizikisht licensë e softit por thjeshtë OE ka paraqitur në kontratë Licensën nr. AAS-50-07062-V4YC-5BQ.

Së dyti, nga verifikimi i faturës tatimore me nr.1813509, datë 19.06.2012 si i vetmi dokument që tregon origjinën e produktit (softit të kërkuar) ndër zërat e vendosura në faturë është dhe shërbimi i mirëmbajtjes së këtij produkti nga shitësi Objektif Luna. Ky shërbim i ofrohet blerësi Kallfa shpk për një periudhë kohore 1 vjeçare. Duke qenë se blerja është kryer në vitin 2012, afati i përfundimit të mirëmbajtjes së produktit software nga shitësi Objektif Luna ka përfunduar në vitin 2013, kjo sipas të dhënave në faturë. Nga sa më sipër OE duhet të kishte paraqitur dokumentat plotësuese ku të provonin që disponojnë soft menaxhimi.

Ankesa e bërë në lidhje me këtë pikë nga OE nuk merret në konsideratë.

Për sa i përket vendimit të KSHA të AK, Ujësjetës Kanalizime SH.A Durrës me anë të shkresës nr.2432/1 prot datë 11.11.2020 "Kthim përgjigje" i cili është teresisht i gabuar si për sa i përket aspektit procedural ashtu dhe atij material do të donim të parashtronim sa më poshtë vijon:

1. Së pari, për sa i përket pretendimit të KSHA të AK se;

".....në lidhje me plotësimin e këtij kriteri OE nuk ka paraqitur një autorizim prodhuesi të softit nga Objectif Luna, autorizim i cili do të bënte lidhjen midis prodhuesit të softit me subjektin Kallfa shpk..."

Do të donim të parashtronim se bazuar në pikën 2.3.8 "Kapacitetet Teknike", të shtojcës 7, në Dokumentat Standarte të Tenderit për procedurën e prokurimit të lartpërmendur, Autoriteti Kontraktor Ujësjetës Kanalizime Sh.A Durrës në të cilin përcaktohet se:

"Operatori ekonomik duhet te disponoje nje soft menaxhimi dhe monitorimi te punes (printimit dhe zarfimit te faturave) ne kohe reale. Per te provuar disponimin e ketij softi duhet te paraqese LICENSEN e software-it ose autorizim prodhuesi te softit ose distributorit."

Për aq kohë sa OE Inpress shpk ka provuar/vërtetuar disponimin e licensës së software "Planet press Production" dhe licencës me nr.AA5-50-07062-V4YC-5BQ ky operator nuk ka asnjë detyrim ligjor të provojë/vërtetojë lidhjen midis prodhuesit të softit me subjektin Kallfa shp. Pasi një gjë e tillë nuk kërkohet nga DST e procedurës së prokurimit.

Pavarësisht këtij fakti OE Inpress ka paraqitur edhe faturë tatimore nr.1813509, datë 19.06.2012 me shitës shoqërinë "Objectif Lune" dhe blerës shoqërinë Kallfa shpk (ku përfshihet edhe licenca me nr.AA5-50-07062-V4YC-5BQ)

2. **Së dyti**, për sa i përket pretendimit të KSHA të AK se;

".....nga OE nuk është paraqitur fizikisht licencë e softit por thjeshtë OE ka përmendur në kontratë licencën me nr.AA5-50-07062-V4YC-5BQ)

..... do të donim të parashtronim se ky konstatim dhe përfytyrimi i gabuar i KSHA mbi "Paraqitjen fizike të licencës së soft-it" është i pa logjikshëm duke patur parasysh llojin dhe veçorinë e produktit të kërkuar "sistem software" i menaxhimit dhe monitorimit të punës, i cili është një produkt virtual.

Ndërsa licenca në vetvete është vetëm numri serial i cili është pasqyruar qartësisht në kontratën për vënien në dispozicion, dhënien e shërbimeve të operimit dhe mirëmbajtjes (për sistemin software ,sistem operativ dhe aplikacion për përpunimin e të dhënave dhe krijimin e fileve për print)-ndërmjet shoqërisë Kallfa shpk (pronari i softit dhe licensës) dhe OE Inpress shpk, datë 06.09.2020- me anë të së cilës OE Inpress shpk i vihet në dispozicion Sistem Software "Planet Press Production".

Pra pasi shoqëria Kallfa shpk (pronari i softit dhe licensës) ka kryer pagesën e faturës tatimore nr.1813509, datë 19.06.2012 me shitës shoqërinë "Objectif Lune" dhe blerës shoqërinë Kallfa shpk, kësaj shoqërie i është dërguar e-mail licenca nr. AA5-50-07062-V4YC-5BQ e cila i jep mundësinë shoqërisë Kallfa shpk të shkarkojë on-line produktin: Sistem Software "Planet Press Production".

Rrjedhimisht nr. AA5-50-07062-V4YC-5BQ është në vetvete licenca për produktin virtual: Sistem Software "Planet Press Production".

3. **Së treti**, për sa i përket pretendimit të KSHA të AK se:

"..... Ndër zërat e vendosura në faturë është edhe shërbimi i mirëmbajtjes së këtij produkti nga shitësi Objektif Luna. Ky shërbim i ofrohet blerësit Kallfa shpk për një periudhë 1 vjecare. Duke qenë se blerja është kryer në vitin 2012, afati i përfundimit të mirëmbajtjes së produktit software nga shitësi Objektif Luna ka përfunduar në vitin 2013, kjo sipas të dhënave në faturë. Nga sa më sipër OE duhet të kishte paraqitur dokumenta plotësuese ku të provonin se disponojnë soft menaxhimi".

..... do të donim të parashtronim se:

a) Shërbimi i mirëmbajtjes si vlefshëm nga prodhuesi për produktin 'sistem software' i menaxhimit dhe monitorimit të punës , nuk është kriter i përcaktuar në DST dhe Nuk kërkohet nga DST e procedurës së prokurimit objekt i kësaj ankese dhe rrjedhimisht nuk mund të përbëjë shkak apo arsye për të skualifikuar një OE pjesëmarrës.

b) Mungesa e një shërbimi të mirëmbajtjes të vlefshëm nga prodhuesi për produktin “System software” i menaxhimit dhe monitorimit të punës nuk nënkupton që shoqëria Kallfa shpk (pronar i softit të licencës) të mos e disponojmë këtë produkt. Disponimi i produktit “Sistem software” është një gjë dhe mirëmbajtja për këtë produkt është një gjë tjetër. Në DST kërkohet vetëm disponimi i produktit dhe Licencës së produktit.

c) Nuk kuptohet si arrin AK në konkluzionin se shoqëria Kallfa shpk (pronari i Softit dhe Licences) nuk ka një shërbim të mirëmbajtjes të vlefshëm nga pridhuesi...? Fare mirë kjo shoqëri mund të ketë (ashtu sic mund edhe të mos ketë) një shërbim të mirëmbajtjes të vlefshëm nga prodhuesi por nisur nga fakti se në DST nuk kërkohet që të vërtetohet ky fakt OE Inpress shpk nuk e ka parë të arsyeshme ta paraqesë një dokument të tillë.

d) Për të gjitha sa u parashtruan më sipër në rastin konkret OE Inpress shpk në përputhje të plotë me pikën 2.3.8 “Kapacitetet teknike” të shtojcës 7, në DST për procedurën e prokurimit të lartpërmendur ka paraqitur/ vërtetuar qartësisht disponimin e Licences së Software (Sistemi Software “Planet Press Production”) me licencë nr. nr. AA5-50-07062-V4YC-5BQ e cila është në pronësi të Kallfa shpk dhe Oe Inpress shpk e disponon atë me anë të Kontratës “Kontratë për vënien në dispozicion, dhënien e shërbimeve të operimit dhe mirëmbajtjes (Për sistemin software (sistem operativ dhe aplikacion) për përpunimin e të dhënave dhe krijimin e fileve për print)”.

Si rrjedhojë bazuar në dokumentacionin ligjor të paraqitur nga OE Inpress shpk vërtetohet qartësisht se ky OE disponon ligjërisht licensën e Software të kërkuar në DST.

Gjithashtu do të donim të theksonim se bazuar në pikën 2.38 “Kapaciteti teknik” sipas shtojcës 7 të DST për procedurën e lartpërmendur të prokurimit disponimi i licences software është një alternativë e autorizimit të prodhuesit ose distributorit.

Si rrjedhojë arsyeja e parashtruar nga AK “...pasi nuk është paraqitur autorizim prodhuesi...” qartësisht nuk qëndron.

Për të gjitha sa u parashtruan më sipër kërkojmë nga KPP;

1. *Ndryshimin e vendimit të AK Ujësjetllës Kanalizime SH.A Durrës;*
2. *Kualifikimin e OE Inpress Shpk;*
3. *Shpalljen fitues të procedurës së prokurimit publik, objekt i kësaj ankese OE inpress shpk.*

II.8. Në datën 04.11.2020, operatori ekonomik ankimues “Inform Albania” sh.p.k ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Adel Co” sh.p.k në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8.1. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, pala ankimuese kundërshton vendimin e KVO-së me argumentat se:

1. **Së pari**, mendojmë se shoqëria Adel Co shpk nuk plotëson kriterin si vijon:

Operatori pjesëmarrës duhet të paraqesë leje mjedisore të tipit C e vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës.

Leja mjedisore e paraqitur nga ky OE nuk ka vlefshmëri përgjatë kohës së zbatimit të kontratës pasi bazuar në ligjin nr. 52/2020 ‘Për disa nryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar, leja e paraqitur është e vlefshme deri me 15 Maj 2021. Brenda këtij afati OE duhet të jetë i pajisur me lejen B dhe në procedurën e aplikimit duhet të kishte paraqitur minimalisht Aplikimin e bërë në QKL. Aplikim i cili shkarkohet nga platforma e-albania.;

2. **Së dyti**, Kemi dyshime se tre makineritë e paraqitura nga ky OE për të përmbushur pikën:

“Operatori ekonomik, duhet të posedojë makineri dixhitale (2 për prodhim normal dhe 1 rezervë në rast defekti). Të paktën 2 makineritë duhet të jenë me ngjyra. Disponimi i makinerive duhet vërtetuar me faturë blerje ose dokument zhdoganimi ose cdo faturë tjetër disponimi që njih Kodi Civil i RSH. Edhe në rastin emarrjes me qera nga kompani tjetër, duhet paraqitur kontrata e qirasë e vlefshme bashkëngjitur fatura e blerjes ose cdo formë tjetër disponimi e njih Kodi Civil i RSH”.

Këto makineri nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në kërkesën e këtij kriteri duke qenë se dokumentacioni i cili vërteton disponueshmërinë e tyre është jo i plotë dhe konform ligjit dhe kërkesave në të.

3. **Së treti** në lidhje me kriterin;

Operatori ekonomik duhet të disponojë një soft menaxhimi dhe monitorimi të punës (printim dhe zafim të faturave në kohë reale). Për të provuar disponimin e këtij softi duhet të paraqesë licencën e software ose autorizimin e prodhuesit të softit ose të distributorit.

Kemi dyshime se Fatura e SW të menaxhimit nuk është e vlefshme pasi kompania që e ka lëshuar nuk është e licensuar për prodhimin e SW të cilët duhet të jenë të certifikuar nga AKSHI. Për rrejdhojë ky OE ka paraqitur një autorizim jo të vlefshëm dhe do të duhet të skualifikohet për dokument të rremë të paraqitur.

4. **Së katërti**, në kërkesën për dorëzimin e sample:

Të paraqesë 10 copë fatura sipas të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara në DST në datën dhe orën e hapjes së procedurës.

Sa më sipër ne dyshojmë se mostrat e paraqitura nga ky OE nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi modelet e faturave të paraqitura në AK si dhe mostrat nuk plotësojnë kushtet teknike pasi modelet e paraqitura nuk janë sipas imazhit të paraqitur në DST dhe nuk kanë linjën e përdorimit horizontal.

Të njëjtin qëndrim mban edhe KPP në raste të ngjashme kur operatori ekonomik nuk paraqesin mostrat në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në DTS ku është përcaktuar se mostrat duhet të sillen sipas specifikimeve të kërkuara.

Sa më sipër kërkojmë:

Pezullimin e procedurës

Shqyrtimin e ankesës së shoqërisë tonë

Rivlerësimin e ofertave të OE pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimim si dhe riklasifikim nga KVO

Skualifikimin e OE “Adel co” shpk.

II.9. Në datën 11.11.2020, nëpërmjet shkresës me nr. 2442/2 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke mos e pranuar ankesën.

II.10. Në datën 16.11.20120 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të ankimuesve, në zbatim të nenit 30, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përfundimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga pretendimet e ankimuesit “Inform Albania” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.1. Marrë shkas nga pretendimet e operatorit ekonomik “Inform Albania” sh.p.k, nga verifikimi i kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në bazë të të cilave është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, një prej kriterëve është hartuar në kundërshtim me legjilacionin në fuqi, pasi shkakton konfuzion e paqartësi në mënyrën e përmbushjes së tij, si dhe në vlerësimin e ofertave, konkretisht vëren se:

III.1.2. Në shtojcën 7, “Kapaciteti teknik” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ndër të tjera autoriteti kontraktor, ka vendosur kriterin si më poshtë vijon:

“11.Operatori pjesëmarrës duhet të paraqesi Leje Mjedisore tipi C e vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës”.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]*”

III.1.4. Në nenin 28, pika 5/a të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

ç) *“licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”*

III.1.5. Në nenin 27/3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “3. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.*

III.1.6. Në nenin 10 pika 1 të ligjit nr. 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, të botuar në fletoren zyrtare me date 28.05.2020, parashikohet se: “*Të gjitha instalimet ekzistuese të tipit C, të cilat, në varësi të kapacitetit referuar shtojcës 1, të këtij ligji, klasifikohen si leje mjedisit të tipit B, aplikojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për t’u pajisur me leje mjedisit të tipit B brenda 12 muajve, nga hyrja në fuqi e ligjit*”.

Për të vazhduar më tej, në ligjin nr. 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar shtojcën 1 pika 7.12 “*Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve*” shkronja “c” përcaktohet veprimtaria “*Procese të tjera rotogravurë, flexografi, stampim/printim me makinë shtypi rotativë, laminim ose lustrim*” do të përfshihen në lejet e tipit B kur “*konsumi i solventëve është më i madh se 15 ton në vit*”. Për këtë referuar ligjit të sipërpërmendur të gjitha instalimet ekzistuese të tipit C, të cilat, në varësi të kapacitetit referuar shtojcës 1, të këtij ligji, klasifikohen si leje mjedisit të tipit B, aplikojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për t’u pajisur me leje mjedisit të tipit B brenda 12 muajve, nga hyrja në fuqi e ligjit.

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton

kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt konkurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtë për drejtë me kriterin e veçantë të vendosur. Lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor se *“Operatori pjesëmarrës duhet të paraqesi Leje Mjedisore tipi C e vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës”* Komisioni thekson se, në nenin 27, pika 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”*, ndërsa në nenin 10 pika 1 të ligjit nr. 52/2020 *“Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, të botuar në fletoren zyrtare me datë 28.05.2020 (hyrë në fuqi me datë 12.06.2020), parashikohet se: “Të gjitha instalimet ekzistuese të tipit C, të cilat, në varësi të kapacitetit referuar shtojcës 1, të këtij ligji, klasifikohen si leje mjedisit të tipit B, aplikojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për t'u pajisur me leje mjedisi të tipit B brenda 12 muajve, nga hyrja në fuqi e ligjit”*.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor ka hartuar një kriter në kundërshtim me dispozitat ligjore pasi leja e mjedisit e tipit C nuk mund të jetë e vlefshme gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës, kohëzgjatja e së cilës referuar pikës 6 të njoftimit të shkurtuar të kontratës është *“12 muaj duke filluar nga dita e neserme e punes pas nenshkrimit të kontratës”* për arsye se ligjit nr. 52/2020 *“Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, i botuar në fletoren zyrtare me datë 28.05.2020, (hyrë në fuqi me datë 12.06.2020) ka parashikuar se të gjithë instalimet ekzistuese të tipit C të cilat në varësi të kapacitetit klasifikohen si leje të tipit B aplikojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për t'u pajisur me leje mjedisi të tipit B brenda 12 muajve, nga hyrja në fuqi e ligjit. Në këto kushte brenda datës 12 Qershor 2021 (12 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit) instalimet ekzistuese të tipit C të cilat në varësi të kapacitetit klasifikohen si leje të tipit B duhet të jenë pajisur me leje të tipi B dhe si rrjedhojë kriteri i kërkuar nga Autoriteti kontraktor *“Operatori pjesëmarrës duhet të paraqesi Leje Mjedisore tipi C e vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës”* është në kundërshtim me ndryshimet ligjore të cilat kanë hyrë në fuqi para se Autoriteti Kontraktor të publikonte procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe të hartonte kriteret e kualifikimit për këtë qëllim. Kriteret e kualifikimit, nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt*

prokurimi me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jo diskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit.

III.1.10. Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se përcaktimi i kriterit për kualifikim *“Operatori pjesëmarrës duhet të paraqesi Leje Mjedisore tipi C e vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës”* është haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik si dhe atë sektorial. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, bazuar në nenin 64, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, gjykon se situata konfuze e krijuar nga përcaktimi i kriterëve për kualifikim haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik si dhe atë sektorial, përbën shkak për anulimin e kësaj procedure konkurruese.

Në nenin 28 pika 2 gërma “d” të Vendimit nr.596/2018 të Komisionit të Prokurimit Publik, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”* parashikohet se: *“[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar: d) Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë autoritetin kontraktues për rifillimin e procedurës së prokurimit [...]”*. Në kushtet kur autoriteti kontraktues ka vlerësuar mbi kriteret haptazi në kundërshtim me legjislacionin, mbi të cilin ka bërë edhe vlerësimin dhe kualifikimin/skualifikimin e operatorëve ekonomikë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendimet e ankimesve nuk do të merren në shqyrtim në themel pasi procedura e prokurimit duhet të anulohet, kjo në përputhje me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, për shkaqet e sipërcituara.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatorët ekonomik *“Inpress”* shpk dhe *“Inform Albania”* shpk për procedurën e prokurimit, me numër REF-74817-10-12-2020, me objekt, *“Shërbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e UKD”*, me fond limit 6.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 23.10.2020, nga autoriteti kontraktor Ujësjellës Kanalizime sh.a Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomik “Inpress” shpk dhe “Inform Albania” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1493 Protokoli, Nr.1501 Protokoli

Datë 13.11.2020, Datë 16.11.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar
Enkeleda Bega**

**Anëtar
Vilma Zhupaj**

**Anëtar
Lindita Skeja**

**Anëtar
Merita Zeqaj**

**Kryetar
Jonaid Myzyri**